



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1137 / Prot
2

Gramsh më 12.04.2021

VENDIM

Nr. 31 dt. 02 /04/2021

PËR

“ Miratimin e vlerës financiare të dëmeve të shkaktuara nga rënia e zjarrit në banesën e z. Avdyl Marishta, banor në fshatin Mashan, Njësia Administrative Kodovjat, si dhe dëmshpërblimin financiar të këtij shtetasi”.

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës 02.04.2021, pasi shqyrtoi relacionin dhe dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, sektori i Emergjencave Civile dhe “Për miratimin e vlerës financiare, të dëmeve shkaktuar nga rënia e zjarrit në banesën e shtetasit **Z. Avdyl Marishta**, banor në Fshatin Mashan, Njësia Administrative Kodovjat, si dhe dëmshpërblimin financiar”, bazuar në:

- Ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligjin 45/2019 “Për mbrojtjen civile”;
- VKM nr.329 datë 16.5.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera, të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”;

V E N D O S I:

1. Miratimin e dokumentacionit tekniko-ligjor për dëmet ndërtimore si dhe ato në pajisje e orendi të hartuar nga specialistët e Bashkisë Gramsh.
2. Të miratojë vlerën e dëmshpërblimit financiar bazuar në V.K.M. Nr. 329 datë 16.5.2012 të përlloritur bazuar në dëmet e shkaktuara nga rënia e zjarrit në banesë, për shtetasin **Z. Avdyl Marishta** në vlerën **146 740** (njëqind e dyzetë ë gjashtë mijë e shtatëqind e dyzetë) lekë.
3. Ti paraqesë dokumentacionin përkatës dhe ti kërkojë mbështetje financiare Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, Ministrisë së Mbrojtjes, për akordimin e dëmshpërblimit prej **146 740** (njëqind e dyzetë ë gjashtë mijë e shtatëqind e dyzetë) lekë. lekë, për shtetasin **Z. Avdyl Marishta**.

4. Ti akordoj familjes së shtetasit Avdyl Marishta, ndihmën emergjente në vlerën prej **50 000 (pesëdhjetë mijë)** lekë nga buxheti i bashkisë Gramsh, fondi i Emergjencave Civile i destinuar dhe i miratuar nga Këshilli i bashkisë për vitin 2021.
5. Ndihma financiare për familjen e shtetasit Avdyl Marishta, përcaktohet sipas kritereve të VKM-së nr.329, datë 16.05.2012.
6. Ndihma financiare që do të akordohet do të përdoret për ti ardhur në ndihmë familjes së shtetasit Avdyl Marishta, banesa e të cilit është dëmtuar nga rënia e zjarrit.
7. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Publike (Sektori I Emergjencave Civile), si dhe Drejtoria e të Ardhurave, Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financar.

Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga Prefekti i Qarkut Elbasan.

Sekretari i Këshillit të Bashkisë

XHULIA GJINI

Konceptoi: Xh. Gjini
Pranoi: G. Lena
Miratoi: G. Lena
Dosja nr: _____
Afati i ruajtjes:

KRYETARI I KËSHILLIT TË BASHKISË

GRETA LENA

